



## **KËSHILLI KOMBËTAR I PAGESAVE**

**në funksion të mbështetjes së reformave në fushën e pagesave, përmes zgjerimit të përfshirjes dhe rritjes së bashkëpunimit në mes të akterëve të ekosistemit të tregut të pagesave në Republikën e Kosovës**

**organizon**

**Takimin e parë (I) për vitin 2025**

**Datë: 17/06/2025**

**Lokacioni: Salla ARTANA - Swiss Diamond Hotel, Prishtinë**

## Objektivat e Takimit<sup>1</sup>

### I. Zhvillimet ne infrastrukturën ligjore dhe teknike në fushën e shërbimeve të pagesave:

1. *Procesi i aplikimit në SEPA dhe mbështetja e Bankës Botërore në projektin e modernizimit dhe integritit rajonal-evropian në fushën e pagesave.*
2. *Planet për avancimin e infrastrukturës teknike të sistemit dhe shërbimeve të pagesave. Implementimin e Sistemit të Pagesave të Shpejta - TIPS clone, ngritja e funksioneve të Sistemit Ndër-bankar të Pagesave-KIPS;*
3. *Veprimet e ndërmarra nga sektori bankar lidhur me fushën e shërbimeve të pagesave; etj.*

### II. Punimet e Këshillit Kombëtar të Pagesave - Prezantime dhe diskutime lidhur me:

1. *Funksionimin e Sistemit Ndër-bankar të Pagesave-KIPS, të dhënat statistikore mbi instrumentet e shërbimeve të pagesave dhe përfshirjen financiare, etj.;*
2. *Veprimet e ndërmarra dhe përgatitja e bankave lidhur me projektin TIPS clone dhe aplikimin në SEPA;*
3. *Projektet lidhur digjitalizimin e shërbimeve financiare, si:*
  - *Themelimi i grupit punues ndërinstitucional për zbatim i kërkesave që lidhen me banking-un e hapur me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Shërbimet e Pagesave;*
  - *Implementimi i IBAN-it, standardizimi i QR kod-it, si dhe qasje e ofrueseve të shërbimeve të pagesave jo banka në sistemet e pagesave.*
  - *Qasja e institucioneve financiare në sistemin e regjistrit civil, si dhe zhvillime tjera nga ofruesit e shërbimeve të pagesave lidhur me digjitalizimin e shërbimeve të pagesave, etj.*

## Audienca e Synuar

Takimi i KKP-se është i sugjeruar për të gjithë akterët vendor të përfshirë në Sistemin Kombëtar të Pagesave të Republikës së Kosovës, si dhe përfaqësues të institucioneve tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare të cilët kanë mbështetur BQK-në në zhvillimin e reformave në fushën e pagesave.

Për më tepër, për shkak të nismave zhvillimore që bazohen në Planin e ri Strategjik të BQK-së (2024-2028), KKP përfshin edhe përbërjen e zgjeruar të përfaqësimit, për përfshirjen e nivelit të duhur të koordinimit dhe bashkëveprimit për të arritur qëllimet e përbashkëta zhvillimore për efekte të shumanshme ekonomike.

---

<sup>1</sup> "Të gjithë pjesëmarrësit janë njoftuar që ky takim nuk përmban ndonjë informacion konfidencial, në kuadër të cilit nuk janë shpalosur informata direkte apo jo-direkte për konkurrencën, duke respektuar rregullat e përcaktuara në pajtim me legjislacionin mbi konkurrencën.

## AGJENDA E TAKIMIT

<b>08:30-09:00</b>	<b>Mirëseardhje dhe Regjistrimi</b>
<b>Fjala Hyrëse</b>	
<b>09:00-09:10</b>	<b><i>Ahmet Ismaili – Guvernator, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës</i></b>
Vështrim i përgjithshëm lidhur me zhvillimet në sistemin financiar, si dhe planin strategjik për integrim dhe digjitalizim në fushën e pagesave.	
<b>09:10-09:20</b>	<b><i>Hekuran Murati – Ministër, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve</i></b>
Strategjia e Qeverisë së Kosovës në digjitalizimit të shërbimeve, përfshirë fushën e pagesave, reduktimit të përdorimit të parasë gatshme dhe luftës ndaj informalitetit.	
<b>Zhvillimet në infrastrukturën ligjore dhe teknike në fushën e pagesave-Aplikimi ne SEPA</b>	
<b>09:20-09:35</b>	<b><i>Dardan Fusha – Zëvendësguvernator për Operacione Bankare, BQK</i></b>
Zhvillimet në infrastrukturën ligjore dhe në infrastrukturën teknike - SEPA dhe TIPS	
<b>09:35-09:50</b>	<b><i>Matija Laco – Project Manager – Payments Modernization Project, World Bank</i></b>
Mbështetja e Bankës Botërore për BQK-në dhe bankat qendrore të shteteve të Ballkanit Perëndimor në modernizimin të shërbimeve të pagesave - SEPA dhe TIPS.	
<b>09:50-10:05</b>	<b><i>Petrit Balija – Drejtor Ekzekutiv, Shoqata e Bankave të Kosovës</i></b>
Veprimet e ndërmarra dhe përgatitja e bankave lidhur me projektin TIPS clone dhe aplikimin në SEPA, si dhe qasja e institucioneve financiare në sistemin e regjistrimit civil dhe zhvillime tjera lidhur me digjitalizimin e shërbimeve.	
<b>10:05-10:20</b>	<b><i>Visar Perani – Country Officer for Kosovo and North Macedonia, International Finance Cooperation, IFC</i></b>
Vështrim mbi projektin për Digital Financial Services – Financuar nga SECO	
<b>10:20 – 10:40</b>	<b>Pushimi i kafes</b>

<b>Punimet e Këshillit Kombëtar të Pagesave-Prezantime dhe diskutime lidhur me:</b>	
<b>10:40-11:00</b>	<b><i>Lumni Rrustolli – Drejtor, Departamenti i Sistemit të Pagesave, BQK</i></b>
	Funksionimin e Sistemit Ndër-bankar të Pagesave-KIPS, të dhënat statistikore mbi instrumentet e shërbimeve të pagesave, si dhe përfshirja financiare, implementimi i IBAN për IFJB dhe udhëzimit të QR Code etj.
<b>11:00-11:10</b>	<b><i>Atdhetar Ibrahim – Përfaqësues nga ofruesit e shërbimeve të pagesave Jo-Banka</i></b>
	Veprimet e ndërmarra nga ofruesit e shërbimeve të pagesave Jo-Banka lidhur me digjitalizimin e shërbimeve të pagesave.
<b>11:10-11:20</b>	<b><i>Jose M. Moreno De Barreda – Global Digital Financial Specialist – International Finance Cooperation, IFC</i></b>
	Mbështetja e IFC lidhur me Projektin për Digjitalizim të Shërbimeve Financiare, paraqitja e pikëpamjes mbi rëndësinë e themelimit të Grupit Punues për Banking-un e Hapur, si dhe qasje e institucioneve financiare në sistemin e regjistrimit civil.
<b>11:20-12:30</b>	<b><i>Dardan Fusha – Zëvendësguvernator për Operacione Bankare, BQK</i></b>
	<p><b>Diskutim i hapur dhe prezantimi i konkluzioneve dhe rekomandimet nga takimi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligji i ri për shërbimet e pagesave dhe legjislacioni sekondar – përgatitjet për SEPA;</li> <li>• Bankingu i Hapur – Themelimi i Grupit Ndërinstitucional për Implementimin e Bankingut të Hapur;</li> <li>• Avancimi i sistemit kombëtar të pagesave nga BQK – KIPS dhe implementimi i pagesave të shpejta TIPS Clone;</li> <li>• Qasja e Ofruesve të Shërbimeve të Pagesave Jo-banka në KIPS dhe në TIPS Clone;</li> <li>• Mundësimi i verifikimit të adresave të klientëve përmes qasjes në Sistemin e Regjistrimit Civilë.</li> </ul>
<b>12:30-14:00</b>	<b>Dreka</b>